

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7074
E martë, 19 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Çitaku: Kontributi i vetëm i LV-së për liberalizimin e vizave është gazi lotsjellës në Kuvend | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) I PËRGJIGJET KËRKESËS SË SERBËVE NË VERI | **FAQE 4-5**

KQZ-ja I HAP RRUGË ORGANIZIMIT TË PETICIONEVE PËR LARGIMIN E KRYETARËVE TË KOMUNAVE NË VERI

HARADINAJ AKUZON LDK-në: ËSHTË NË MBËSHTETJE TË MASHTRIMEVE TË KURTIT DHE OSMANIT **F. 3**



SERWERI: REZULTATI I ZGJEDHJEVE NË SERBI S'ËSHTË SHENJË E MIRË PËR KOSOVËN **F. 3**



Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ), Valmir Elezi, ka njoftuar të hënën se u është kthyer përgjigje kryesuesve të kuvendeve komunale në tri komunitat e banuara me

shumicë serbe në pjesën veriore të vendit, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok, në lidhje me nismën për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në katër komunitat veriore

AKTUALE



MINISTRIA E SHËNDETËSISË NË GAZË: MBI 100 TË VRARË NGA SULMET E FUNDIT IZRAELITE **F. 2**

VUÇIË FITON ZGJEDHJET NË SERBI, OPOZITA KËRKON ANULIMIN E ZGJEDHJEVE NË BEOGRAD **F. 3**

OSMANI PRET NË TAKIM ABDIXHIKUN, TEMË DISKUTIMI DRAFSTATUTI I ASOCIACIONIT **F. 5**

EKONOMI

SHKATËRRIMIN E EKONOMISË VENDORE NGA PRIVATIZIMI I EGËR DO TA VAZHDOJË FONDI SOVRAN **F. 9**

Shkruan:
Safet GËRHXHALIU



GUVERNATORI I BQK-së, ME FTESË TË ODËS AMERIKANE, DISKUTOI LIDHUR ME SEKTORIN FINANCIAR DHE PLANET PËR AVANCIMIN E TIJ **F. 8**

SPORT



KURTI DHE CAPRALOSI FLASIN PËR PENGESAT E SPORTISTËVE PËR PJESËMARRJE NË GARA NDËRKOMBËTARE **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tajvani sërish detekton balona kineze

TAIPEI, 18 DHJETOR - Dy balona kineze fluturuan në veri të Tajvanit, tha Ministria e Mbrojtjes tajvaneze, përderisa Kina ka rritur presionin ndaj ishullit vetëqeverisës, që pretendon se i përket, para zgjedhjeve presidenciale të janarit. Balonat kaluan në Ngushticën e Tajvanit që ndan ishullin nga Kina dhe u detektuan të dielën rreth 204 kilometra në veriperëndim të qytetit-port të Kilungut, tha Ministria.

Kjo është hera e dytë gjatë këtij muaji që Tajvani raporton për balona kineze afër territorit të tij, pasi një balonë kishte kaluar në Kilung më 7 dhjetor.

Potenciali i Kinës për të përdorur balona të motit për t'i spiunuar qeveritë e tjera u vu në fokus më herët gjatë këtij viti, kur Shtetet e Bashkuara rrezuan një balonë të dyshuar spiunazhi të Kinës mbi Oqeanin Atlantik, veprim që nxiti

zemërim në Kinë.

Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit nuk tregoi nëse dyshon që balonat janë përdorur për spiunazh. Ndërkaq, Ministria e Jashtme e Kinës nuk ka komentuar këto pretendime tajvaneze.

Pekini ka rritur presionin ndaj Tajvanit duke dërguar avionë ushtarakë dhe luftanije afër ishullit pothuajse në baza ditore.

Taipei po përgatitet t'i mbajë zgjedhjet presidenciale më 13 janar. Kandidati kryesor në zgjedhje është zëvendës-presidenti William Lai. Ai është kritikuar nga Pekini dhe Kina e ka cilësuar atë si "separatist".

Tajvani u nda nga Kina gjatë luftës civile më 1949, por Pekini vazhdon të pretendojë se ishulli prej 23 milionë banorësh është territor kinez, duke mos përfshirë as përdorimin e forcës që ta rimarrë atë.



Ministria e Shëndetësisë në Gazë: Mbi 100 të vrarë nga sulmet e fundit izraelite



GAZA, 18 DHJETOR - Ministria e Shëndetësisë në Rripin e Gazës e kontrolluar nga Hamasi - grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Britania - tha se që nga 17 dhjetori nga sulmet izraelite në veri të territorit janë vrarë të paktën 110 palestinezë. Përmes një deklaratë të shkurtër, ministria tha se 50 persona janë vrarë "nga sulmet e pushtuesit ndaj shtëpive në Xhabalia", duke bërë që numri i viktimave në këtë zonë që nga dita e diel të arrijë në 110. Këto

pretendime të Ministrisë së Shëndetësisë në Rripin e Gazës nuk kanë mundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur.

Të premten, më 15 dhjetor, Ministria e Shëndetësisë në Gazë tha se mbi 18 700 persona janë vrarë që kur Izraeli nisi ofensivën hakmarrëse në Gazë në fillim të tetorit.

Lufta u nxit pasi grupi radikal, Hamas, kreu sulme të befasishme në jug të Izraelit më 7 tetor. Gjatë këtyre sulmeve u vranë 1 200 persona, shumica

civilë, dhe u morën peng afër 240 burra, gra dhe fëmijë.

Liderët izraelitë po përballen me thirrje ndërkombëtare për arritjen e një armëpushimi të ri me Hamasin, me qëllim që të lirohen më shumë pengje.

Izraeli ka thënë se ofensiva e tij në Gazë që ka pësuar shkatërrim të madh si pasojë e luftës do të vazhdojë derisa të largohet nga pushteti Hamasi, të shkatërrohen aftësitë ushtarake të këtij grupi radikal dhe të shpëtohen të gjitha pengjet.

ShBA-ja kërkon ndryshimin e qasjes së ofensivës së Izraelit në Gazë

UASHINGTON, 18 DHJETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, pritet t'i bëjë presion Izraelit që ta përfundojë ofensivën e tij të madhe në Gazë gjatë vizitës në këtë vend. Kjo vizitë paraqet testin e fundit nëse ShBA-ja mund ta përdorë mbështetjen e saj të palëkundur për Izraelin për ta zbutur ndikimin shkatërrues të ofensivës ndaj civilëve palestinezë.

Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, që janë disa prej aleateve më të ngushta të Izraelit, iu bashkuan thirrjes globale për armëpushim gjatë fundjavës dhe protestuesit izraelitë kërkuar që qeveria t'i rinisë bisedimet me Hamasin - grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Britania - për të liruar më shumë pengje, pasi tre pengje



u vranë gabimisht nga trupat izraelite.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka insistuar që Izraeli do të vazhdojë të luftojë derisa të largojë nga pushteti Hamasin, t'i shkatërrojë aftësitë e tij ushtarake dhe të kthejë pothuajse 129 pengjet që ky grup radikal mori gjatë sulmit fillestar të 7 tetorit, që nxit luftën.

ShBA-ja ka vendosur veto ndaj thirrjeve ndërkombëtare për armëpushim dhe i ka dërguar armatim Izraelit por, po ashtu, ka kërkuar që Izraeli të ndërmarrë hapa për t'i shmangur viktimat në mesin e civilëve.

Gjatë dhjetë javëve luftë në mes të Izraelit dhe Hamasit janë vrarë mbi 18 700 palestinezë dhe Gaza ka pësuar dëme të mëdha.

Rreth 1.9 milion palestinezë -

pothuajse 85 për qind e popullsisë së Gazës - janë larguar nga shtëpitë e tyre dhe shumica janë vendosur në strehimore të udhëhequra nga Kombet e Bashkuara dhe kampe të tjera në pjesën jugore të territorit të rrethuar.

Austin, që së bashku me kryetarin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralin CQ Brown, do të qëndrojnë në Izrael, pritet t'u bëjë presion liderëve izraelitë që të kalojnë në një fazë më precize, me operacione të shënjestruara që do ta synonin vrasjen e liderëve të Hamasit, shkatërrimin e tuneleve dhe shpëtimin e pengjeve.

Lufta Izrael - Hamas nisi pas sulmeve befasuese të grupit radikal në jug të Izraelit. Hamasi vrau 1 200 persona, shumica civilë, dhe rëmbeu afër 240 burra, gra dhe fëmijë.

Vuçiqi fiton zgjedhjet në Serbi, opozita kërkon anulimin e zgjedhjeve në Beograd



Prishtinë, 18 dhjetor - Lista e Partisë Përparimtare Serbe "Aleksandar Vuçiq - Serbia nuk guxon të ndalet", ka fituar 46.6 për qind të votave në zgjedhjet e 17 dhjetorit, që nënkupton 129 ulëse në Parlament, sipas sondazheve të organizatës joqeveritare Qendra për Zgjedhje të Lira dhe Demokraci. Në vendin e dytë është koalicioni opozitar "Serbia kundër dhunës", me 23 për qind të votave apo 63 ulëse. Në vendin e tretë është Partia Socialiste Serbe e ish-ministrit të Jashtëm serb, Ivica Daçiç, me 6.9 për qind të votave apo 19 ulëse.

Daçiçi ka shprehur gatishmëri të bashkëpunojë me partinë e Vuçiqit.

Sipas sondazheve, nga listat e komuniteteve, Shaip Kamberi e ka siguruar një ulëse të komunitetit shqiptar, Aleanca e Hungarezëve të Vojvodinës pritet të fitojë gjashtë ulëse, koalicioni i kroatëve të Vojvodinës tri ulëse dhe një ulëse ka fituar Partia Ruse.

Serbia ka mbajtur të dielën zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, lokale e krahinore. Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare ishte 57.65 për qind.

Një total prej 18 partive dhe aleancave kanë garuar për ta fituar mbështetjen e 6.5 milionë banorëve, me të drejtë vote, për përfaqësim në Parlamentin me 250 ulëse.

Pragu për hyrje në Parlament është 3 për qind.

Fillimisht numërohen votat për Parlament, më pas për krahina dhe ato lokale.

Koalicioni opozitar "Serbia kundër dhunës" pretendoi se Partia Progresive Serbe (SNS) ka marrë 21 000 vota më shumë se lista e tyre në zgjedhjet në Beograd. "Duke pasur parasysh se më shumë se 40 000 persona pa vendbanim të ligjshëm u sollën në Beograd në mënyrë të organizuar për ta mbështetur listën e SNS-së, e cila ndryshoi në

mënyrë drastike vullnetin elektorale të qytetarëve të Beogradit, ne kërkojmë anulimin e zgjedhjeve në qytetin e Beogradit dhe përsëritjen e votimit për Kuvendin Komunal", tha koalicioni.

Nga ky koalicion, po ashtu, kërkuar "pastrimin e listës zgjedhore".

Ndërkaq, Qendra e Pavarur për Hulumtim, Transparencë dhe Llogaridhënie (CRITA) tha se më 17 dhjetor kanë parë indikacione se votuesit janë sjell nga Bosnjë-Hercegovina dhe ish-republika të tjera jugosllave për të votuar në zgjedhjet në Serbi.

Më herët, SNS hodhi poshtë akuzat se ka ndikuar në vullnetin e qytetarëve gjatë zgjedhjeve të 17 dhjetorit.

Presidenti i SNS-së, Millosh Vuçeviq, deklaroi se është "i sigurt" se lista e tij ka fituar në kryeqytetin serb, Beograd, dhe se ai beson se Aleksandar Shapiq do të jetë "kryetari i ri apo i vjetër" i qytetit.

Shaip Kamberi fiton edhe një mandat të deputetit në Parlamentin e Serbisë

Ish-kryetari i Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve në Serbi, Ragmi Mustafi, tha për Radion Evropa e Lirë se në këto zgjedhje votuesit shqiptarë treguan "maturitet dhe pjekuri të lartë, madje kanë refuzuar politikën e konfrontimit me Prishtinën dhe Tiranën". "Kanë zgjedhur politikën e bashkëpunimit dhe bashkërendimit me Prishtinën dhe Tiranën duke thënë se armiqtë nuk i kemi në Prishtinë e Tiranë dhe duke theksuar se duhet rezistencë ndaj Beogradit", tha ai.

Duke komentuar fitimin e mandatit të deputetit nga Shaip Kamberi, Mustafi tha se Kamberi do të tregojë për shkeljet ndaj shqiptarëve në Luginën e

Preshevës - Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, por edhe do të jetë "një zë i arsyeshëm që kërkon zgjidhje demokratike drejt Bashkimit Evropian dhe jo drejt Rusisë dhe Kinës".

Sa i përket rezultatit të listës zgjedhore të presidentit serb Aleksandar Vuçiq, Mustafi tha se kjo është dëshmi se Serbia "është zhytur në një narracion, në një politikë që është fashiste, në një politikë e cila refuzon tjetrin, në një politikë e cila largon tjetrin, nuk e dëshiron të ndryshmen, por që i ka dhënë fuqi të jashtëzakonshme një lideri, një diktatori i cili qëllimet e tij politike nuk i sheh vetëm drejt Bashkimit Evropian, por edhe në marrëdhënie me Rusi e Kinë".

Serweri: Rezultati i zgjedhjeve në Serbi s'është shenjë e mirë për Kosovën

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka krijuar një sistem të padrejtë zgjedhor që e favorizon atë, thotë Daniel Serwer, profesor në Universitetin amerikan "Johns Hopkins", në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë".

Të dhënat paraprake të zgjedhjeve të 17 dhjetorit tregojnë se Partia Përparimtare Serbe, e udhëhequr deri vonë nga

Vuçiqi, ka fituar shumicën. Lista opozitare "Serbia kundër dhunës" ka kërkuar, ndërkohë, anulimin e zgjedhjeve në Beograd, duke pretenduar se ka pasur parregullsi.

Duke komentuar fitoren e Vuçiqit në raport me Kosovën, Serweri thotë se rezultati "nuk është një shenjë e mirë" për marrëdhëniet mes dy vendeve. "Nuk shoh asnjë shenjë se Vuçiqi është gati

për një ndryshim serioz sa iu përket marrëdhënieve me Kosovën. Përkundrazi, ai është nisur në drejtim të kundërt. Ai sërish bën thirrje për vendosjen e sovranitetit të Serbisë. Ai e kundërshton rëndësinë e marrëveshjeve të marsit dhe shkurtit [Marrëveshjes së Ohrit dhe Aneksit për zbatimin e saj], të cilat ShBA-ja dhe BE-ja thonë se janë ligjërish të detyrueshme", thotë Serweri.





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ) I PËRGJIGJET KËRKESËS SË SERBËVE NË VERI

KQZ-ja i hap rrugë organizimit të peticioneve për largimin e kryetarëve të komunave në veri

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ), Valmir Elezi, ka njoftuar të hënën se u është kthyer përgjigje kryesuesve të kuvendeve komunale në tri komunat e banuara me shumicë serbe në pjesën veriore të vendit, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok, në lidhje me nismën për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në katër komunat veriore

Ai tregoi edhe për numrin e përgjithshëm të qytetarëve me të drejtë vote në tri komunat, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok, si dhe numrin e saktë të votuesve që përbëjnë 20 për qind të trupit votues në secilën

komunë, që është i nevojshëm për shkarkimin e një kryetari komune përmes peticionit. “Ju njoftoj se gjatë ditës KQZ-ja u ka kthyer përgjigje të tre kryesuesve të Kuvendeve Komunale për Leposaviq, Mitrovicë të Veriut dhe

Zubin Potok, të cilët më 12 dhjetor i parashtruan KQZ-së dy pyetje të njëjta. Lidhur me këto përgjigje janë njoftuar edhe tri grupet nismëtare si dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Së pari, nga verifikimet, KQZ-ja

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka hapur rrugë organizimit të peticioneve për largimin e kryetarëve në tri komunat me shumicë serbë në veri të Kosovës, pasi i ka kthyer përgjigje zyrtare kërkesës së tre kryesuesve të kuvendeve komunale për komunat përkatëse, njoftoi të hënën zëdhënësi i komisionit, Valmir Elezi.

Elezi tha se KQZ-ja i ka njoftuar kryesuesit e tri kuvende komunale, tri grupeve nismëtare dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës (MAPL), lidhur me numrin e përditësuar të votuesve të regjistruar në këto komuna “mbi bazën e të cilit përlllogarit numri minimal i nevojshëm i nënshkrimeve prej 20-përqindësh”. “KQZ-ja përmes këtyre tri përgjigjeve të ndara ka njoftuar se anëtarët e tri grupeve nismëtare janë votues të komunave përkatëse”, tha Elezi.

Hapat drejt zgjedhjeve, sipas udhëzimit

Udhëzimi Administrativ për largim të kryetarit të komunës, i lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i parashih këta hapa: Kërkesa duhet të bëhet nga i ashtuquajtur grup nismëtar, i cili përbëhet nga tre apo më shumë persona me të drejtë vote në komunën përkatëse. Ky grup e njofton kryesuesin e Kuvendit Komunal për

kërkesën në fjalë dhe pajiset me dokumentacionin e nevojshëm. Më pas grupit i duhet të mbledhë një minimum prej 20-përqindësh të nënshkrimeve të qytetarëve me të drejtë vote, me kërkesë për largim të kryetarit. Lista me nënshkrime duhet dërguar kryesuesit të Kuvendit Komunal, e cila më vonë përfundon në Komisionin

Qendror Zgjedhor. Nëse KQZ-ja vlerëson se kushtet janë përmbushur, organizohen zgjedhjet për largimin e kryetarit. Nëse në ato zgjedhje sigurohen 50 për qind plus 1 votë për largim të kryetarit, ai largohet prej funksionit dhe organizohen zgjedhje të reja. Në rast të kundërt, iniciativa dështon. Ajo do të mund të përsëritej vetëm pas një viti.

Osmani pret në takim Abdixhikun, temë diskutimi drafstatuti i Asociacionit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur takim me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, me qëllim të diskutimit për zhvillimet e fundit në vend. Në takim me kreun e LDK-së, presidentja Osmani e ka njoftuar Abdixhikun për zhvillimet në fushën e sigurisë dhe të politikës së jashtme. Në këtë kontekst, presidentja Osmani i ka falënderuar të gjitha subjektet opozitare për mbështetjen ndaj institucioneve të sigurisë në përballje me agresionin e Serbisë. Më tej, Osmani me Abdixhikun kanë diskutuar për drafstatutin e Asociacionit dhe në këtë kontekst ka ritheksuar se Gjykata Kushtetuese është institucioni që duhet ta bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë, duke u udhëhequr nga parimi i pavarësisë dhe profesionalizmit.

Ndërkaq, siç njofton Presidenca, Abdixhiku e ka njoftuar Osmanin lidhur me shqetësimet e LDK-së sa i përket përmbajtjes së drafstatutit dhe janë diskutuar mundësitë për trajtimin e këtyre shqetësimeve në mënyrë që mos të lejohen dykuptimësi që mund ta dëmtojnë funksionimin e brendshëm të Republikës së Kosovës. Presidenca ka bërë me dije se ftesat për takim u janë dërguar edhe subjekteve të tjera opozitare. "Institucioni i Presidencës është vazhdimisht i hapur për koordinim me parti dhe institucione për çështje të rëndësishme nacionale. Në kuadër të konsultimeve të fundvitit, krahas takimeve me krerë të institucioneve dhe të partive politike, presidentja Osmani do të mbajë takime edhe me përfaqësues të komuniteteve joshumicë në Kuvend, me shoqërinë civile dhe me mediet", ka njoftuar Presidenca e Kosovës.



Çitaku: Kontributi i vetëm i LV-së për liberalizimin e vizave është gazi lotsjellës në Kuvend

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se është lajm i mirë, ndonëse i vonuar,

liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës. Ajo thotë se kontributi i vetëm i LV-së dhe Kurtit në këtë proces është gazi lotsjellës në

Kuvend dhe dhuna verbale e fizike e cila na vonoi me vite. "Sa për freskim të kujtesës, LV-ja as MSA-në, me të cilën sot mburren, nuk e

kanë votuar. E sa për sukseset të cilat vendet tjera mund t'i shohin vetëm në ëndërr, më së miri flasin konkluzat e BE-së; aplikacioni i

Kosovës për statusin e vendit kandidat mbetet i patrajtuar, dhe sanksionet vazhdojnë", ka shkruar Çitaku në "Facebook".



përmes këtyre përgjigjeve të ndara ka njoftuar se anëtarët e tri grupeve nismëtare, të cilët janë nga tre anëtarë për secilën komunë, janë votues të komunave përkatëse. Së dyti, KQZ-ja i ka njoftuar kryesuesit e tri kuvendeve komunale, tri grupet nismëtare dhe MAPL-në, edhe lidhur me numrin e përditësuar të votuesve të regjistruar në këto komuna, mbi bazën e të cilit përlogarit numri minimal i nevojshëm i nënshkrimeve prej 20-përqindësh", ka thënë ai.

Elezi ka theksuar se numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote në komunën e Leposaviqit është 13 441. "Nga ky numër, 2 689 përbëjnë 20 për qind të trupës elektorale në këtë komunë. Në komunën e Zubin Potokut numri i qytetarëve me të drejtë vote është 6 732. 20 për qind e votuesve në këtë komunë është 1 347. Në komunën e Mitrovicës së Veriut numri i votuesve është 18 199. Sipas përlogaritjeve, 3 640 votues përbëjnë 20 për qind të trupës

elektorale", ka pohuar ai. Më 7 dhjetor katër grupe nismëtare, veç e veç, secili i përbërë nga tre qytetarë, u dorëzuan kryesuesve të kuvendeve komunale të katër komunave në veri kërkesat për iniciimin dhe organizimin e peticioneve për largimin e kryetarëve të komunave. Ky është ndër hapat e parë që parashihet me Udhëzimin Administrativ të cilin MAPL e nxori në shtator për largimin e kryetarit të komunës nga

funkcioni, por u hodh poshtë. Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, tha për Radion Evropa e Lirë më 14 dhjetor se kërkesa e grupeve nismëtare nuk u pranua sepse ato s'e kishin njoftuar fillimisht kryetarin ose Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për formimin e peticionit. "Ata nuk e kanë bërë këtë dhe nuk dëshirojnë ta bëjnë. Ndërkaq, mua kështu më udhëzon Udhëzimi Administrativ", tha Uglanin.

Për arsyen e njëjtë, sipas tij, nuk ishin pranuar as kërkesat e nismëtarëve të peticioneve për largimin e kryetarëve në tri komunat e tjera, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Ato kërkesa "kanë qenë të njëjta dhe pa ndonjë dallim", tha Uglanin. Kryetarët shqiptarë janë vendosur në objektet komunale në veri në fund të majit, hap që ka nxitur protesta të serbëve lokalë. Ata i kanë fituar zgjedhjet e mbajtura në prill, të cilat janë bojkotuar nga serbët atje.

Në Prishtinë fillon aksioni për mbledhjen e dhuratave për fëmijët në asistencë sociale

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se të hënën, në bashkëpunim me Radio Televizionin e Kosovës dhe NPL Sport Marketing Sh. A., filluan zyrtarisht aksionin për mbledhjen e dhuratave për fëmijët në asistencë sociale.

“Ju presim çdo ditë nga ora 09:00 - 18:00 në shtëpizën e vendosur në hapësirat e RTK Radios, sheshi ‘Xhorxh Bush’ në Prishtinë. Ne bashkë mund të bëjmë shumë për këta fëmijë. Kryeqyteti Prishtina, përveç dhuratave, gjatë gjithë vitit ka siguruar shujta të ngrohta, çdo ditë, për 300

familje. Ua kemi siguruar drutë për ngrohje 340 familjeve, dhe kemi paguar kursin e notit 100 fëmijëve. Por patjetër se na duhet edhe bashkëpunimi i juaj qytetarë, në mënyrë që askush të mos ndihet i lënë anash e i pa përfshirë”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



Mbi 40 mijë euro dyshohet se u vodhën në një këmbimore të kriptovalutave në Prishtinë



PRISHTINË, 18 DHJETOR - Mbi 40 mijë euro dyshohet se janë grabitur të hënën në një këmbimore të kriptovalutave në lagjen “Tophane” në Prishtinë.

Pronari i këmbimores “ExCoins”, Valton Isufi, ka konfirmuar për “Telegraf”-in se personat e armatosur kanë grabitur mbi 40 mijë euro. “Mbi 40 mijë euro janë grabitur nga persona të armatosur”, tha ai duke shtuar më tej se me rastin po merret policia. Policia ka njoftuar për rastin, duke konfirmuar se rasti ka ndodhur

rreth orës 10:00. “Sot rreth orës 10:00 është raportuar për një grabitje të ndodhur në një këmbimore në lagjen Tophane në Prishtinë. Pas marrjes së informacionit policia ka dalë në vendngjarje dhe, bazuar në informacionet e para, dyshohet se nën kërcënim të armës është grabitur një shumë parash”, ka konfirmuar zëdhënësjja e Policisë së Kosovës për rajonin e Prishtinës, Flora Ahmeti. Policia, në koordinim me prokurorinë, po ndërmer

veprimet e nevojshme policore me qëllim të zbardhjes së rrethanave të rastit.

Numri i grabitjeve të armatosura është rritur kohën e fundit në Kosovë. Para disa ditësh persona të armatosur kishin kryer grabitje edhe në një argjendari në Suharekë.

Policia kishte arritur t'i identifikonte personat e dyshuar. Një prej tyre edhe kishte refuzuar të dorëzohej. Ai ishte neutralizuar nga policia, ndërsa të tjerëve u është caktuar masa e paraburgimit.

Nis ndërtimi i rrugës nga fshati Billushë deri në aksin rrugor Zhur - Dragash

Prizren, 18 dhjetor - Komuna e Prizrenit ka filluar punimet për ndërtimin e rrugës nga fshati Billushë deri në aksin rrugor Zhur - Dragash. Lajmin e ka bërë me dije kryetari i kësaj komune, Shaqir Totaj. “Filluan

punimet për ndërtimin e rrugës nga fshati Billushë deri në aksin rrugor Zhur - Dragash, që do ta shkurtojë distancën e udhëtimit për banorët e zonës”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Latifi mban takimin e radhës me drejtorët komunalë, njoftohet me punët e secilës drejtori

RAHOVEC, 18 DHJETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur mbledhjen e rregullt javore me drejtorët e drejtorive komunale, me të cilët ka diskutuar për një varg çështjesh të angazhimeve ditore, planeve të mëtejme në secilin sektor të komunës,

raportet për punët javore, si dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar. “Këto takime kanë për qëllim bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet drejtorive, duke ndihmuar në koordinimin e përpjekjeve për t’u avancuar më tutje”, ka thënë Latifi.

Abdixhiku drekon me Hovenierin: Kosova nuk ka aleat më të afërt se ShBA-në

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka takuar ambasadorin amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier. Në një shkrim në “Facebook”, ai tha se për festat e fundvitit ka qenë i ftuar në drekë te rezidenca e Hovenierit. “Drekat e punës me

ambasadorin Jeff Hovenier janë gjithmonë të këndshme. Dhe kjo e sotmja, në rezidencën e tij, ishte e tillë. Veçse e shoqëruar me një dhuratë fundviti, një pako ëmbëlsirë nga Tacoma e shtetit të Uashingtonit. Me ambasadorin Hovenier ndamë pikëpamjet tona mbi

zhvillimet politike në vend. Kosova nuk ka aleat më të afërt se ShBA-të; dhe LDK do t’i ruajë këto relacione në çdo veprim të saj; duke avancuar gjithnjë interesin tonë shtetar. Ambasadorin e falënderova për një vit të shkëlqyeshëm bashkëpunimi me LDK-në”, ka shkruar Abdixhiku.



Hoxhaj: Kosova po e përmbyll këtë vit pa asnjë rezultat në politikën e jashtme. Mjerim!

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka drejtuar kritika për qeverinë Kurti në raport me politikën e jashtme. Ai ka theksuar se çoroditja e politikës së jashtme të Kosovës dhe kultura e papërgjegjshmërisë së kësaj qeverie tregojnë se kryeministri Kurti, në vend se ta kishte si rezultat të

fundvitit marrjen e statusit të kandidatit të BE-së, marrjen e Partneritetit për Paqe të NATO-s, anëtarësimin në Këshillin e Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në ndonjë organizatë ndërkombëtare, sot bëri me dije se Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës i është bashkuar Këshillit të Arkitektëve të Evropës si anëtar vëzhgues,

që është meritë e vet arkitektëve dhe jo e politikës së Kosovës. "Kjo tregon se Kosova e përmbyll këtë vit pa asnjë rezultat të vetëm dhe vetëm me lajme për vizitat jashtë vendit që s'kanë qenë asgjë më shumë se vetëm turizëm politik. Çfarë ngadhënjimi qesharak i diplomacisë sot dhe çfarë mjerimi politik!", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook".



Haradinaj akuzon LDK-në: Është në mbështetje të mashtrimeve të Kurtit dhe Osmanit

Prishtinë, 18 dhjetor - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Lidhja Demokratike e Kosovës është në mbështetje, siç i quan ai, të mashtrimeve të kryeministrit Albin Kurti dhe presidentes Vjosa Osmani.

Haradinaj në një bisedë për "Kosovapress" ka akuzuar LDK-në se në shumë situata nuk ka qenë e unifikuar me opozitën dhe ka mbështetur pushtetin.

Haradinaj ka folur edhe për draftstatutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të propozuar nga emisarët euroamerikanë, për të cilin thotë se ka elemente shqetësuese, mirëpo theksoi se Gjykata Kushtetuese mund ta pastrojë atë dhe t'i largojë nenet jokushtetuese. "Të gjithë të tjerët nga Lista Vetëvendosje, Osmani, Konjufca, janë staf i Kurtit dhe përcjellin mashtrimin e Kurtit, janë pjesë e këtij mashtrimi. Për fat të keq, edhe një pjesë e opozitës sonë. Shihet se LDK-ja është në mbështetje të këtyre mashtrimeve në shumë situata deri më sot, që nga votimi i presidentes, pastaj mospërkrahja e mocionit dhe në shumë raste edhe kjo prezenca për t'i bërë një lloj dekorimi fjalimit vjetor të presidentes, e cila s'pati



asnjëherë gjatë gjithë vitit një qëndrim të prerë për cilëndo çështje të rëndësishme të jetës sonë", ka thënë Haradinaj.

Lideri i AAK-së ka kërkuar nga kryeministri Kurti të tregojë se si e ka paraparë implementimin e

Asociacionit meqenëse, sipas tij, e ka pranuar të njëjtin në kuadër të marrëveshjes së Brukselit, madje ka kërkuar edhe nënshkrimin e palës tjetër. Haradinaj e sheh të pamundshme të ndryshojë

versioni i draftstatutit të Asociacionit pavarësisht prej vërejtjeve të kryeministrit Kurti te ndërmjetësit. Andaj ai thotë se nëse dokumenti dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese, kësajsoj siç u është prezantuar

partive opozitare, atëherë do të dërgojnë komente në kushtetuese për t'i kundërshtuar disa nene të draftstatutit të Asociacionit. "Qeveria duhet të tregojë se si e ka paraparë implementimin, meqenëse e ka bërë një pranim në planin ndërkombëtar dhe tani çka pason. Nëse logjika është se qeveria dokumentin e paprekur, pa ndërhyrje fare, e dërgon në Gjykatën Kushtetuese, atëherë palët e shqetësuara, palët e tjera, dërgojnë komente, pra bëjnë ankesë. Ne si Aleancë mund t'i dërgojmë komente, mund ta kundërshtojmë në disa nene këtë draftstatut të Asociacionit. Komentet (vërejtjet e qeverisë) nuk vlejnë më pas gatishmërisë për ta pranuar. Ju lutem, komentet kanë vlejtur deri para këtij qëndrimi të qeverisë, në kuptimin për t'ia dërguar BE-së. Por në momentin kur kryetari i qeverisë ka deklaruar se është i gatshëm për nënshkrim, por kërkon nënshkrimin edhe të palës tjetër, atëherë me siguri kjo situatë ka përfunduar. Pra nuk ekziston mundësia e komentimit të ndërmjetësit, por prapëseprapë besoj se është e mundshme që Gjykata Kushtetuese ta pastrojë këtë dokument prej disa pikave që ndërhyjnë në Kushtetutën e vendit", ka theksuar Haradinaj.

Katër persona shpallen fajtorë për terrorizëm

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Katër persona janë shpallur fajtorë për vepra penale që lidhen me terrorizmin apo kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës.

Gjykata Themelore në Prishtinë shpalli aktgjykimin ndaj të akuzuarve me iniciale A. Gj., E. S., N. S. dhe M. B. për veprën penale "Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës".

Sipas njoftimit, E. S., M. B. dhe A. Gj. u gjetën fajtorë edhe për veprën "Mbajtja në pronësi,

kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve". I akuzuari N. S. u gjet fajtor për veprën "lehtësim dhe financim i terrorizmit".

Për shkak të mungesës së provave, A. Gj. është liruar në mungesë provash nga vepra penale "Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale". Seanca për caktimin e dënimit është caktuar për 25 janar.

Aktakuza ndaj katër të akuzuarve ishte ngritur në dhjetor të vitit 2022. Atëbotë Prokuroria Speciale e Kosovës kishte njoftuar se katër personat akuzoheshin se nga

marsi i vitit 2021 deri në tetor të po atij viti kishin bërë përpjekje të krijonin një strukturë organizative "për kryerjen e akteve terroriste në Kosovë".

Sipas aktakuzës, katër të pandehurit kishin kontaktuar me një person që kishte një gradë të lartë "në organizatën terroriste Shteti Islamik" dhe ishin angazhuar që të siguronin armatime të ndryshme.

Dy prej të pandehurve, sipas Prokurorisë Speciale, u akuzuan se kishin fshehur armë të zjarrit dhe municion të



llojeve të ndryshme të cilat i kishin vendosur në bure të plastikës dhe i kishin goposur. Sipas ligjeve në Kosovë, për vepra terroriste dhe kundër rendit kushtetues parashihen

dënime të ndryshme. Që nga viti 2015 në Kosovë ndalohet pjesëmarrja në luftëra të huaja dhe, sipas ligjit, parashihen dënime deri në 15 vjet burgim.

Shkatërrimin e ekonomisë vendore nga privatizimi i egër do ta vazhdojë Fondi Sovran



Shkruan: **Safet GËRXHALIU**, ish-kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

Nuk jam në politikë dhe nuk i takoj asnjë partie politike në Kosovë. E dua Kosovën mbi të gjitha dhe Republika e Kosovës është e arritura më e madhe në botën shqiptare për mua. Se Republika e Kosovës sot udhëhiqet nga ata që e mendojnë si shtet të përkohshëm e dimë. Se qeverisin ata që nuk e pranojnë flamurin e Republikës së Kosovës edhe këtë e keni ditur. Por se të

njëjtët dëshirojnë me çdo kusht ta shkatërojnë edhe atë pak ekonomi që ka mbetur nuk e kam besuar.

Të paraqitet Fondi Sovran si e arritura më e madhe e Kosovës dhe si shpëtimi i Kosovës, kjo e dëshmon mjerimin që e ka kapluar Republikën e Kosovës.

Të thuash se Fondet Sovrane në Norvegji, Singapor, Kuvajt dhe Slloveni kanë qenë të suksesshme dhe do t'i zbatojmë të njëjtat modele në Kosovë, edhe kjo e dëshmon mjerimin e padijenisë krahasimtare në mes të shteteve dhe parametrat ekonomikë që i karakterizojnë ato.

Me çka mund të krahasohet ekonomia e Kosovës me atë të Singaporit, Kuvajtit, Norvegjisë dhe Sllovenisë përheq emrit ekonomi.

Janë shtete dhe qytete që janë të zhvilluara ekonomikisht duke pasur stabilitet politik, pra me

ekonomi të zhvilluar, me eksporte të shumta, me inovacione, edukim modern, investime të huaja, pasuri natyrore dhe, mbi të gjitha, sundim të rendit dhe ligjit, e pa probleme politike e dialog me Serbinë si Kosova.

Aty ku është lufta ekonomike, aty duhet të jetë ushtria e "ekspertëve" ekonomikë e jo lufta në Kosovë e ushtria në Londër, Paris, Bruksel e Uashington.

Republika e Kosovës është shumë më ndryshe sa u përket parametrevë ekonomikë se sa që mendohet dhe duket duke qëndruar në metropolet evropiane. Fondi Sovran nuk duhet të shihet vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në dimensionet tjera si politik, social dhe mbi të gjitha nga momentumi politik dhe raportet në dialog.

Analizojeni ndërmarrjen "Trepça" dhe kërkesat për kthimin e borxhit

që është mbi 1.5 miliard euro? Kush dëshiron ta hapë këtë kuti të Pandorës në dëm të Kosovës dhe në favor të armiqve të saj?!

Analizojeni situatën aktuale ekonomike dhe mjerimin që i ka kapluar ndërmarrjet publike në çdo aspekt.

Ky projektligj do të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, por deri kur kështu?!

Miratohej e votohej ligje në Parlamentin e Republikës së Kosovës që paraprakisht dihet që do të përfundojnë në Gjykatën Kushtetuese vetëm për ta sfiduar atë dhe për ta dëmtuar imazhin e Republikës.

Në qoftë se mendohet se në këtë Fond Sovran do të futen mjetet e Trustit Pensional dhe ato të procesit të privatizimit atëherë është një kalkulim sa i gabuar po aq edhe i rrezikshëm. Pa stabilitet politik dhe mbyllje të problemeve

të hapura me Serbinë, funksionimi i Fondit Sovran do të jetë sfidues dhe ndoshta temë e gjykatave dhe arbitrazheve ndërkombëtare.

Orientimi në ekonomi majtiste është rreziku më i madh i ekonomisë së tregut?!

A mos do të kërkohet edhe heqja e nenit 10-të nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Depolitizimi i ekonomisë dhe orientimi në profesionalizëm e jo vetëm në përkatësi politike e partiake është një ndër hapat e parë që duhet zbatuar.

Dialogu publiko-privat dhe orientimi pro biznes dhe pro sektorit privat është më se i nevojshëm në këtë situatë.

Eksperimentet e tilla ekonomike pa stabilitet politik do të kenë pasoja edhe më shqetësuese në të ardhmen e Republikës së Kosovës.

Guvernatori i BQK-së, me ftesë të Odës Amerikane, diskutoi lidhur me sektorin financiar dhe planet për avancimin e tij



PRISHTINË, 18 DHJETOR - Performanca e sektorit financiar në Kosovë, planet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 e tutje, avancimi i legjislacionit në fushën financiare ishin temat e diskutimit ndërmjet anëtarëve të Odës Ekonomike Amerikane dhe guvernatorit të BQK-së, Ahmet Ismaili.

Drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, ka falënderuar guvernatorin Ismaili për gatishmërinë dhe sinqeritetin për të diskutuar me përfaqësues të sektorit privat, duke ofruar edhe gatishmërinë e Odës Amerikane për dialog konstruktiv me Bankën

Qendrore të Kosovës.

Guvernatori Ismaili e vlerësoi të rëndësishme mundësinë e diskutimit me përfaqësues të sektorit privat, me qëllim të të kuptuarit sa më të drejtë të brengave dhe shqetësimeve të cilat ata mund të kenë, duke qenë kontribuues me peshë në ekonominë e vendit dhe sektorin financiar.

Ai foli për një përgjegjshmëri dhe kulturë të mirë të kthimit të kredive në Kosovë, gjë që reflektohet edhe në normën e ulët të kredive joperformuese.

Guvernatori theksoi të arriturat brenda sektorit financiar, duke

njoftuar dhe specifikuar treguesit e likuiditetit, kapitalizimit, raportin ndërmjet kredive dhe depozitave si dhe tregues të tjerë relevantë në pajtim me kornizën rregullative.

Ai tha se aktivitetet e Bankës Qendrore për vitin 2024 dhe vitet në vijim bazohen në strategjinë e re pesëvjeçare të institucionit i cili ai drejton, e prioritetet të së cilës strategji përfshijnë digjitalizimin, pagesat e shpejta (instant), rritjen e konkurrencës në sektor, qasjen në financa dhe një politikë gjithëpërfshirëse.

Anëtarësimi në Zonën e Vetme të Pagesave të Bashkimit Evropian (SEPA), listimi i Kosovës në

platformat globale të pagesave elektronike, si dhe mundësi i pajisjes me Kartonin e Gjellbër, ishin çështjet u diskutuan.

Guvernatori ftoi edhe komunitetin e biznesit që të identifikojë zgjidhje të mundshme dhe bashkëpunuese për t'i adresuar sfidat dhe çështjet aktuale në interes të vendit.

Guvernatori bëri edhe vlerësimet më të larta për qeverinë amerikane për rolin e rëndësishëm në fuqizimin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve brenda industrisë financiare në vend. Në këtë aspekt ai përmendi edhe iniciativën për marrjen e vlerësimit kreditor të

Kosovës, i cili po bëhet me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

USAID-i po ndihmon edhe në zhvillimin e tregjeve të kapitalit, sipas guvernatorit.

Guvernatori Ismaili foli edhe për planet për promovimin e uljes së përdorimit të parasë së gatshme në transaksionet e përditshme, duke filluar nga ato në vlerat më të ulëta, për çka tha se duhet të gjenden modalitetet nxitëse në mesin e konsumatorëve, që ndihmon edhe në luftimin e ekonomisë joformale, përveç përfitimeve të tjera.

Charles Dickens: Një zë për të varfërit



Me vdekjen e Charles Dickensit në vitin 1870, një epitaf qarkulloi në Londër duke e shpallur shkrimtarin e ndërës si “një simpatizues me të varfërit, të vuajturit dhe të shtypurit”. Nuk ishte pa arsye. Veprat e tij mbeten sinonim i pjesës së poshtme të shoqërisë viktoriane, një peizazh i banuar nga jetimët, punëtorët e fabrikave, prostitutat dhe ata që ishin zhytur në kohë të vështira. Dickens u dha atyre një zë, u dha dinjitet. Dhe kjo trashëgimi mbizotëroi. Disa dekada më vonë, kritiku GK Chesterton e etiketoi Dickensin “zëdhënës të të varfërve”. Shumë besonin se romanet e tij kishin ribërë pjesërisht axhendën politike dhe sociale.

KRITIKA

Por, jo të gjithë e mendonin kështu. George Orwell ishte ndër kritikët më të mprehtë kur ishte fjala për përkushtimin real të Dickensit ndaj reformës sociale. Orwell thoshte se pjesa më e madhe e aksionit në romane zhvillohet në mjedise të klasës së mesme, që paraqesin “borgjezinë tregtare londineze dhe vendet ku ata rrinin”. Të varfërit e vërtetë,

pretendonte Orwell, ishin lënë pas dore nga shkrimtari. “Ai nuk ka portret të një punëtori në bujqësi dhe vetëm një (Stephen Blackpool tek “Kohë të Vështira”) të një punëtori industrial.” Duke shkruar në vitet 1930, Orwell pohoi se “nëse pyet një lexues të zakonshëm se cilin nga personazhet proletarë të Dickensit mund të kujtojë, tre nga ata që është pothuajse e sigurt se do të përmendë janë Bill Sikes, Sam Weller dhe Zonja Gamp. Një hajdut, një shërbëtor dhe një mami e dehur – jo tamam një grup përfaqësues i klasës punëtore angleze.”

Orwell shkoi më tej, duke e dënuar Dickensin se nuk ishte një shkrimtar mjaftueshëm revolucionar. Pavarësisht imazhit të tij popullor si një kampion i të varfërve, ai nuk bëri thirrje për ristrukturimin e shoqërisë, për të krijuar një klimë më të barabartë. “Në realitet, objektivi i tij nuk ishte dhe aq shoqëria, se sa “natyra njerëzore”, argumentonte Orwell. “I gjithë ‘mesazhi’ i tij është klishe: nëse njerëzit do të sillleshin mirë, bota do të ishte e denjë.

Pavarësisht mungesës së

atributeve dhe përcaktimeve të renditura nga Orwelli, Dickens ishte jashtëzakonisht popullor tek të varfërit, madje edhe anëtarët analfabetë të shoqërisë që paguanin për t’ua lexuar dikush tjetër, pjesën e re të veprës së tij të fundit. Duke vendosur një pjesë të mirë të skenave të librave të tij në mjedise të njohura për ta, Dickens nxiti një etje për letërsi serioze që dikur e kishin humbur.

Dhe Dickens i njihte vendet për të cilat shkruante. Ndryshe nga Orwelli, Etoniani i Vjetër, ai kishte përvojë më të drejtpërdrejtë me jetën në kohë të vështira. Në vitin 1824, i dërrmuar nga borxhet në rritje, babai i tij Xhon, u dërgua në një burg debitorësh, ku iu bashkua gruaja dhe fëmijët e tyre më të vegjël. 12-vjeçari Charles jetonte në një sërë banesash nëpër qytet; ai më vonë do të mbështetej tek pronarët dhe pronaret e tij, kur i popullonte romanet me londinezët e pasur. Ai detyrohej gjithashtu të punonte 10 orë në ditë në një magazinë – “një shtëpi e vjetër e çmendur, e rrënuar... e tejmbushur me minj” – duke u ngjitur etiketat vazove me lustër çizmësh. Kjo përvojë, e

zhvendosur në një fabrikë shishesh, do të rivizitohej tek David Copperfield. Atje ai punoi së bashku me fëmijë të varfër të klasës punëtore, duke përfshirë një farë “Bob Fagin” – një emër që do ta huazonte tek Oliver Twist – duke i dhënë atij një pasqyrë rinore në një anë krejtësisht të ndryshme të shoqërisë.

Dickens tregoi padiskutim empati të pamatë ndaj të varfërve që punojnë dhe atyre në shtresat më të ulëta të shoqërisë, që luftojnë për të përmirësuar veten në një sistem të manipuluar, qofshin këta fëmijë jetimë apo gra, siç është prostituta Nancy tek Oliver Twist. Ky vështrim dhe shqetësim nuk u shtri tek ata që nuk bëjnë mirë që përdorin krimin për të mbijetuar, apo për të përparuar në kurriz të të tjerëve. Ai nuk ishte admirues i turmës, e parë në portretizimin e rebelëve – pjesëmarrës tek trazirat antikatolike të Gordonit të vitit 1780 – tek Barnaby Rudge.

PISLLËK DHE SHKATËRRIM

Pavarësisht nga dështimet e tij

të perceptuara, kur i popullonte romanet me njerëz nga shtresat më të varfra të shoqërisë dhe cialtdo qofshin dështimet e tij të perceptuara, për të ofruar zgjidhje për zhdukjen e varfërisë, vepra e Dickensit megjithatë hodhi një dritë të fortë në qoshtet më të errëta të shoqërisë angleze – dhe, më së shpeshti, të Londrës.

Këto ishin qoshe të injoruara shumë kollaj nga bashkëkohësit e Dickensit. Letërsia e tij shkon në lagje të pa vizituara kurrë nga penat e të tjerëve. Shihni jetën reale të ishullit Jacob në bregun jugor të Tamizit, të përshkruar në faqet e Oliver Twist, se si përmban shtëpi “aq të ndyra, aq të mbyllura, sa ajri do të dukej se ishte shumë i ndotur edhe për papastërtitë dhe mjerimin”. Në minimumin e tyre absolut, veprat e Charles Dickensit u ofruan shumë prej lexuesve të tij bashkëkohorë një dritare në një shtresë të shoqërisë përndryshe të padukshme për ta, një botë të fshehur. Romanet e tij mund të mos kenë çuar në reforma sociale në nivelin që është perceptuar zakonisht, por prodhimi i tij artistik me siguri e drejtoi vështrimin kolektiv drejt sëmundjeve shoqërore të Anglisë Viktoriane. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Faton Neziri, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 18-të (të fundit të stinorit vjeshtor) në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Dukagjini,

Faton Neziri. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Shyqeri Salihu. Bujar Asllani dhe Synaj Keqi. Ky komision vlerësoi që Faton Neziri me golin e shënuar dhe me paraqitjen e tij në ndeshjen

kundër Gjilanit ishte përcaktues për fitoren e Dukagjinit. Pasi mori këtë çmim, Fatoni u shpreh për vlerësimin si më i miri i xhiros dhe për faktin që skuadra e tij e mbylli stinorin me fitore. "Është kënaqësi e veçantë të shpallej 'Ylli i javës'. Ky është

çmimi im i parë si lojtar i KF Dukagjini. Ky sezon ka shkuar mirë për ekipin tonë, por shpresoj që sezoni pranveror do të jetë edhe më i mirë. Falënderoj bashkëlojtarët dhe shtabin teknik për përkrahjen dhe ju premtoj që do të vazhdojmë të punojmë



ndeshje pas ndeshje", ka thënë Neziri për faqen zyrtare të FFK-së.

Kurti dhe Capralosi flasin për pengesat e sportistëve për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Presidenti i Komitetit Olimpik të Evropës (EOC), Spyros Capralos dhe sekretari i përgjithshëm, Raffaello Pagnozzi, janë pritur nga kryeministri Albin Kurti dhe ministri për Kulturë, Rini e Sport, Hajrulla Çeku. Capralos shoqërohej nga drejtuesit e KOK-ut, presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm Besim Aliti, si dhe drejtuesit e KOKSh-it, presidenti Fidel Ylli dhe sekretari i përgjithshëm Gerti Shima. Kryeministri Kurti, që shoqërohej nga ministri i Financave, Hekuran Murati dhe zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, foli për kandidaturën e fituar të Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030", investimet që do të bëhen në infrastrukturën sportive, si dhe përkushtimin që ka qeveria për zhvillimin e sportit, duke shtuar se pikërisht Ministrisë për

Kulturë, Rini dhe Sport i kanë ndarë buxhetin më të madh për vitin e ardhshëm. "Kryeministri u ndal edhe te sukseset e sportistëve tanë, konkretisht ato të xhudos, si dhe Kampionatin Evropian të Hapur, të organizuar në Prishtinë, duke paralajmëruar edhe ngjarje të tjera madhore në vendin tonë, ndërsa përmendi edhe sfidën e moslemimit të sportistëve tanë në gara ndërkombëtare te shtetet që e përzijnë politikën me sportin", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Edhe ministri Çeku foli për sukseset e Kosovës në sport, organizimet ndërkombëtare që po bëhen në Kosovë dhe përkushtimin që ka MKRS-ja në mbështetjen e lëvizjes olimpike në Kosovë dhe sportit në përgjithësi, si dhe projektin e MKRS-së për përfshirjen e sporteve të caktuara në shkollë. "Presidenti Capralos veçoi të



arriturat e sportit tonë, me theks të veçantë tri medaljet olimpike të Kosovës dhe progresin që ka bërë KOK-u në dy, tri vitet e fundit, duke thënë se ne jemi storje suksesi edhe për Komitetet Olimpikë të shteteve të mëdha. I

pari i lëvizjes olimpike të Evropës u shpreh se marrja e organizimit të LM Prishtina 2030 është rast i mirë që shteti të investojë në infrastrukturën sportive", thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës.

Ndërsa presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, falënderoi EOC-un në krye me Capralosin për bashkëpunimin dhe mbështetjen e KOK-ut në projekte të ndryshme, derisa u shpreh mirënjohës edhe për Qeverinë e Kosovës dhe MKRS-në për mbështetjen e fuqishme në fitimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030".

I pari i KOKSh-it, Fidel Ylli, theksoi se bashkëpunimi mes dy Komiteteve Olimpikë është në nivel të lartë jo vetëm për organizimin e LM Prishtina 2030, por edhe në projekte të ndryshme të përbashkëta, derisa përgëzoi infrastrukturën ligjore që ka Kosova dhe kërkoi që shteti të investojë edhe më shumë në infrastrukturë ashtu siç ka bërë dhe po bën Shqipëria. EOC po zhvillon vizitë dyditëshe në Kosovë, ndërsa të dielën vizitoi KOK-un.

Napoli - Barcelona dhe Inter - Atletico, përballjet kryesore në Ligën e Kampionëve

NYON, 18 DHJETOR - Në Nyon të Zvicrës është tërhequr shorti i raundit të fazës 1/16-të të Ligës së Kampionëve 2023/24. Ndeshja kryesore në këtë fazë është ajo në mes të Napolit dhe Barcelonës, pa harruar edhe përballjen tjetër në mes të Interit dhe Atletico Madridit. Ndeshjet e para të së tetës së finale do të luhen më 13 e 14 shkurt e 20/21 shkurt të vitit që vjen, kurse ato të kthimit më 2/3 mars dhe 12/13 mars. Pas Ligës së Kampionëve u hodh shorti në Ligën e Evropës. Milani i eliminuar nga Liga e Kampionëve e ka "peshkuar" Rennesin, ndërsa Roma do ta sfidojë



ÇIFTET E LIGËS SË KAMPIONËVE

Porto - Arsenal
Napoli - Barcelona
PSG - Real Sociedad
Inter Milan - Atletico Madrid
PSV - Borussia Dortmund
Lazio - Bayern Munchen
Copenhagen - Manchester City
RB Leipzig - Real Madrid

ÇIFTET NË LIGËN E EVROPËS:

Roma - Feyenoord
Milan - Rennes
Lens - Freiburg
Young Boys - Sporting
Benfica - Toulouse
Braga - Qarabag
Galatasaray - Sparta Praga
Shakhtar Donetsk - Olympique Marseille

Feyenoordin. Ndeshjet e para janë planifikuar më 15 shkurt, ndërsa të kthimit më 22 shkurt. Në raundin me eliminim direkt, 1/16 finale, fillimisht

janë shortuar ekipet te renditura të dytat në grupe me ato që vinin si vende të treta nga Liga e Kampionëve.

Davis, MVP i javës në Superligë

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Java e 13-të në elitën e basketbollit të Kosovës solli ndeshje interesante, duke veçuar derbin në mes të Trepçës dhe Bashkimit dhe Pejës e Sigal Prishtinës. Basketbollisti me indeksin më të lartë ishte Kevin Davis i Trepçës,

i cili ndaj prizrenasve ndeshjen e mbylli me 24 pikë, shtatë kërcime dhe tri asistime, duke e pasur indeksin e lojës 32, apo më të lartin. Në fitoren e Sigal Prishtinës ndaj Pejës u dalluan Shaheed Davis dhe Derrick Wilson. Davisi e përfundoi

ndeshjen me 26 pikë, nëntë kërcime dhe katër asistime, kurse Wilson me 13 pikë, nëntë kërcime dhe gjashtë asistime. Në një garë interesante, Golden Eagle Ylli mundi Proton Cable Prizrenin, ku te therandasit, qendra e Kosovës, Gëzim

Morina, kishte 17 pikë, shtatë kërcime dhe pesë asistime. Vëllaznimi regjistroi fitoren e shtatë në këtë edicion, duke mundur Istogun. Më i miri te kuqezinjët ishte Burim Zekiqi me 19 pikë, tri kërcime dhe një asistim.



Kosova U17 kërkon në Uzbekistan biletën për në Kampionat Botëror

PRISHTINË, 18 DHJETOR - Pasi e ka fituar garën IHF Trophy për Zonën Evropiane, Përfaqësuesja U17 e Kosovës në hendboll (vajzat) e ka siguruar të drejtën e paraqitjes në IHF Trophy Ndërkontinentale. Federata Ndërkombëtare e Hendbollit (IHF) ka vendosur që IHF Trophy InterContinental të mbahet në Tashkent të Uzbekistanit.

Kampionati ka peshë shumë të madhe për shkak se është kualifikues për Kampionatin Botëror të hendbollistëve të reja. Me këtë synim të madh në mendje vajzat tona do të udhëtojnë për në Uzbekistan. IHF Trophy Ndërkontinentale do të mbahet prej 27 shkurtit deri më 3 mars të vitit të ardhshëm. Të kujtojmë që Kombëtarja U21

e Kosovës në hendboll është e vetmja prej të gjitha sporteve që deri më tani është kualifikuar dhe është paraqitur në Kampionat Botëror. Tani këtë e synon edhe Kombëtarja U17, që në tetor e fitoi vendin e parë në IHF Trophy për Zonën Evropiane. Në finale vajzat tona kishin fituar ndaj Bosnjë-Hercegovinës me rezultat 39:33.



Kane kap shifrën e 20 golave: Kjo ishte paraqitja më e mirë e sezonit

MUNCHEN, 18 DHJETOR - "Uragani" Harry Kane nuk di të ndalet, "trafshon" edhe Shtuttgartin duke udhëhequr Bayern Muncheni në suksesin e radhës në Bundesligë. Gjigantët gjermanë siguruan një fitore të pastër 3-0, ku "sulmuesi anglez realizoi një "dopietë" golash. Kapitenit të "Tre Luanëve" i mjaftuan dy minuta lojë për ta kaluar Bayernin në avantazh. VAR-i ua anuloi vendësve dy gola brenda pjesës së parë, Kim dhe Muller, por me fillimin e pjesës së dytë askush nuk arriti ta ndalë Kane që realizoi golin e dytë personal dhe të dytin për Bayernin. Për t'i mbyllur llogaritë me Shtuttgartin mendoi Kimi në minutën e 63-të duke siguar shifrat në 3-0. "Jam shumë i kënaqur, kjo ishte një fitore e merituar kundër një rivali me kualitet", u shpreh Tuchel pas ndeshjes. Me këtë "dopietë", Harry Kane shkon në kuotën e 20 golave në Bundesligë, shifra të



jashtëzakonshme, por anglezi në reagimin e tij pas këtij sukcesi vlerësoi lojën e ekipit: "Kjo ishte mbase paraqitja më e mirë e

sezonit. Ne dëshironim ta tregonim dominimin tonë, kishim intensitet të lartë, të gjithë zhvilluan një ndeshje të shkëlqyer".

Bostoni dhe Milwaukee ndeshen për kreun në Lindje, Golden State del nga kriza



BOSTON, 18 DHJETOR - Golden State e mposhti me rezultat 118-114 Portlandin jashtë fushës, duke korrur fitoren e dytë radhazi. Sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për Warrirosin u dallua Klay Thompson, autor i 28 pikëve,

mbështetur edhe nga Wiggins me 25. Granti realizoi 30 pikë për vendasit, por që mbetën për statistikë. Pa shumë probleme fitoi edhe Milwaukee, që mundi me shifrat 128-119 Houstonin. Edhe pse për teksanët 7 lojtarë realizuan

mbi 10 pikë, kjo nuk mjaftoi për të fituar. Damian Lillard me 39 pikë e 11 asistime si dhe Antetokounmpo me 26 pikë e 17 rebounde bënë dallimin në fushë për Bucksin. Bostoni bëhet ekipi i parë që arrin kuotën e 20 fitoreve, duke mposhtur Orlandon (114-97), ndeshje e dominuar nga vendasit. Të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Browni me 31 pikë. Phoenixi, falë 55 pikëve të dyshes Durant - Booker, mundi me rezultat 112 - 108 Washingtonin.

REZULTATET

Boston - Orlando	114-97
San Antonio - New Orleans	110-146
Milwaukee - Houston	128-119
Phoenix - Washington	112-108
Portland - Golden State	114-118

SHKURT

Klopp: Nuk e mbaj mend një paraqitje kaq dominuese ndaj Unitedit

Trajneri i Liverpoolit, Jurgen Klopp, ka thënë se skuadra e tij bëri paraqitje të mirë ndaj Manchester Unitedit pavarësisht se kjo sfidë përfundoi me rezultat 0-0. Strategu gjerman i Liverpoolit është i bindur se skuadra e tij ishte dominuese ndaj Unitedit. "Nuk e mbaj mend një paraqitje kaq dominuese kundër Manchester Unitedit", ka thënë Kloppi. Derisa në lidhje me penalltinë e mosakorduar për Liverpoolin, Kloppi ka thënë se në atë rast gaboi gjyqtari. Liverpooli është në vendin e dytë në Premierë Ligë me 38 pikë, një më pak se lideri i tabelës, Arsenali.

Inzaghi: Nuk ishte një fitore për titull

Interi e mposhti në derbi Lazion (0-2), por trajneri Simone Inzaghi ka thënë se kjo fitore nuk ishte për titull të kampionit në Serimë A. "Jo, nuk ishte një fitore për titull. Ishte një fitore e rëndësishme, por mungojnë edhe 22 ndeshje të tjera. Duhet të vazhdojmë në këtë mënyrë, të luajmë si skuadër", u shpreh Inzaghi.

Aktualisht Interi është në vendin e parë me 41 pikë, katër pikë më shumë se Juventusit që zë vendin e dytë.

Franca shpallet kampione e botës në hendboll për femra

Franca është kampione e botës në hendboll (femra). Franca ka regjistruar një fitore me rezultat 31-28 (20-17) ndaj Norvegjisë. Në një atmosferë drithëruese është zhvilluar finalja në palestrën "Jyske Bank Boxen" në Herning të Danimarkës para 12 mijë shikuesve. Franca ka dëshmuar lojë më të mirë se Norvegjia sidomos në pjesën e parë shkëputet në epërsi me tre gola (20-17) në minutën e 30. Norvegjia ia doli ta ngushtojë rezultatit në 26-25, por jo edhe të barazojë. Në minutën e 53-të francezet shtojnë epërsinë në katër gola (29-25) ndaj norvegjezeve. Pas tre minutave (29-27) ngushtohet. Ndeshje e luftuar deri në fund, ndërsa Franca nuk ka lejuar që të thyhet rezultati i saj duke fituar me 31-28 e duke u shpallur kampione e botës.

Barcelona e gatshme ta shesë Raphinhan

Raphinha është pjesë e Barcelonës me shumë se një vit, por ai nuk po bind me paraqitjet e tij dhe klubi spanjoll ka vendosur ta nxjerrë në shitje. Braziliانى provon në çdo ndeshje, por kontributi i tij me gola dhe asistime është shumë më i ulët sesa që pritej. Sipas gazetës "SPORT", katalanasit do të mirëprisnin oferta për kartonin e tij. Ka zëra nga Arabia që janë disa klube të interesuar për të, por interesim ka treguar edhe Manchester Unitedi. Nga ana tjetër, Raphinha nuk dëshiron të largohet pasi dëshiron të fitojë trofe dhe të ketë sukses me një nga klubet më të mira në botë.

Mourinho: E dija që do të ishte e vështirë pa Lukakun dhe Dybalan

Roma u mund nga Bologna (2-0) në Serinë A. Duke folur pas kësaj disfate, trajneri i "verdhekuqve", Jose Mourinho, e vendosi theksin te mungesa e Dybalas dhe Lukakut, ndërsa shtoi se pa ta e

dinte se do ta kishin të vështirë sfidën me Bolognan. "Pa Dybalan dhe Lukakun e dija se do të ishte e vështirë. Djemtë sigurisht që donin të bënin më mirë, por ne kishim probleme në nivelin taktik

dhe vështirësi të mëdha në nivelin fizik. Mancini është në vështirësi të mëdha dhe po luan me dhimbje në ije sepse skuadrës i duhet. Ai është shembull", ka thënë Mourinho. Tekniku portugez

komentoi edhe zëvendësimin pas vetëm 17 minutash në fushë të mesfushorit Renato Sanchez. "I kërkoj ndjesë Renato Sanchezit për zëvendësimin e shpejtë. Është diçka e rëndë për futbollistët, por

edhe më e rëndë për trajnerët. E kam bërë vetëm 3-4 herë në karrierë", ka deklaruar Mourinho, i cili e mbylli konferencën duke theksuar se dëshiron të qëndrojë te Roma.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
N.P.L. PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 1800/23
Data: 18.12.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, lidhur me pozitën e punës e cila është e paraparë me nenin 16 nën pikën 1.7.3 të Rregullores Nr. 35/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A e miratuar me datë 06.05.2023 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. 1799/23 të datës 18.12.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A me datë 18.12.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo filllore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që e kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 18.12.2023 deri me datë 03.01.2024 në ora 16:00.

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimiti për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
N.P.L. PËRPARIMI SH.A - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 1800/23
Data: 18.12.23

Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, u vezi sa radnim mestima koja su predviđena članom 16 pododjeljkom 1.7.3 Pravilnika br. 35/23 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u N.P.L. "Përparimi" Sh.A, odobrenom dana 06.05.2023. od strane Stručnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh.A, i na osnovu odluke br. 1799/23 od godine 18.12.2023 izvršnog direktora, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, dana 18.12.2023 objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Fizičko obezbeđenje

Broj izvršilaca:

Radno vreme: 40 sati nedeljn

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6)

meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Srednja škola i Osnovna škola

Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci

Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;

Koeficijent plate: 3.9

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, mozetakode je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;
- Prednost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L. "Përparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavni formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Përparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastrioti Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 18.12.2023 deri me datë 03.01.2024 u 16:00 časova. N.P.L. "Përparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Teuta Haliti shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit "Fama" Prishtinë, drejtimi Bachelor i Arteve Psikologji e Përgjithshme.

Gezuar Selimaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Sali Bubani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Mati Ligoreci" Prizren.

Lulzim Zyberi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Fevzi Vasija shpall tr pavlefshme certifikatën dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Bislim Thaçi shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

